



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

Data 05.02.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Furnizime dhe shërbime me ushqim për mënajat (për nevojat e Qendrës Ditore të Zhvillimit)”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Qumësht i freskët llopi 03333000-4
Produkte shtazore, mish dhe produkte të mishit 15100000-9
Mish 15110000-2
Prodime mishi 15130000-8
Djathë i freskët 15542000-9
Gjizë 15542100-0
Produkte të ndryshme të qumështit 15550000-8
Kos dhe produkte të tjera të fermentuara të qumështit 15551000-5
Miell gruri 15612100-2
Produkte ushqimore të ndryshme 15800000-6

VLERA E FONDIT LIMIT:

1 416 390 (njemilion e katërqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e treqind e nëntëdhjetë) leke **pa tvsh**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor BASHKIA KORÇE ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2022,2023,2024**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **40%** e vlerës të parashikuar të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenet 43 pika 2c dhe 55 pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Ky kriter i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, prandaj është kërkuar që vlera e xhiros të jete jo më e vogël se 40 % të vlerës të përlogaritur të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 43 pika 2c dhe nenin 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 pika 1 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ligjin nr. 29/2023 Për Tatimin mbi të Ardhurat, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

*AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje Nenin 61 të ligjit Nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”: 1. Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjitha të ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor. 2. **Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.***

2.2 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

-Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë gjithashtu edhe Kontraten e Bashkimit te operatoreve ekonomikë.

-Per kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë gjithashtu edhe Kontratën baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor si dhe Miratimin zyrtar si nenkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 20% të vlerës te perlllogaritur te kontratës qe prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 20 % e vlerës te perlllogaritur te kontratës qe prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.3. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.3.1 Operatorët Ekonomike pjesëmarrës duhet të paraqesë në emër të tij licencën II.1.A.1 ”Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”. Në rastet kur operatorët ekonomikë, nuk kanë detyrim ligjor të licencohen nga QKB me kete licence, duhet të paraqesin ekstraktin tregtar, ku në fushën e veprimtarisë të jetë i përfshirë edhe objekti që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”; Ky kriter është vendosur bazuar në ligjin Nr.10 081, datë 23.2.2009, për” Liçensat, Autorizimet dhe Lejet në RSH”; dhe Rekomandim nr. 10181 prot., datë 19.11.2018, “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimoree” të hartuar nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.

2.3.2 Operatorët Ekonomike pjesëmarrës duhet të jenë te pajisur me:

1. Certifikatë të Sistemit të Menaxhimit të cilesise ISO 9001:2015, ose ekuivalente me to.
2. Certifikatë të Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore ISO 22000:2018, ose ekuivalente me to.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në Rekomandim nr. 10181 prot., datë 19.11.2018, “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore” të hartuar nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit. Kriteri për certifikatë të Sistemit të Menaxhimit të cilesise ISO 9001:2015, është vendosur në bazë të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion certifikimet e duhura për mallrat objekt prokurimi.

2.3.3 Operatorët Ekonomike pjesëmarrës duhet të disponojë:

1- Magazine ushqimore dhe ambjente frigoriferike në pronesi, në përdorim ose qera të vertetuara me kontratë noteriale. Për të vertetuar këtë operatori duhet të paraqesë:

- Licence nga QKL me kodin II.1.B” Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njëzë)”,
- Akt miratimi higjieno sanitar,
- Certifikata e mbrojtjes nga zjarri,
- Foto të ambjenteve të ushtrimit të aktiviteteve.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në Rekomandim nr. 10181 prot., datë 19.11.2018, “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore” të hartuar nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës duhet të vetdeklarojë se, nga kontrolli i fundit i ushtruar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Rekomandimin e Përbashkët të AKU dhe APP Nr. 10181 Prot datë 19.11.2018” Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të Veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”, Pika III gërma” g” Hartimi i kriterëve të Veçanta Për Kualifikim.

2.3.5 Operatorët Ekonomike pjesëmarrës duhet të disponojnë një automjet për kryerjen e furnizimit të ushqimeve si buke dhe fruta perime. Për të vërtetuar këtë fakt duhet të paraqesë kopje të lejes së qarkullimit, siguracionit, pagimin e taksave vjetore, kryerjen e

kontrollit teknik vjetor. Ne rastin e disponimit te mjetit me qera duhet te paraqese kontraten noteriale te qerase.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

2.3.6 Operatorët Ekonomike pjesëmarrës duhet të disponojnë një automjet frigoriferik për kryerjen e furnizimit të ushqimeve vezë, qumësht dhe nënprodukte të tij si dhe mishit dhe nënprodukteve të tij. Për të vërtetuar këtë fakt duhet të paraqesë kopje të lejes së qarkullimit, siguracionit, pagimin e taksave vjetore, kryerjen e kontrollit teknik vjetor, si dhe lejen higjieno sanitare. Ne rastin e disponimit te mjetit me qera duhet te paraqese kontraten noteriale te qerase.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 45, pika 5/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet për kryerjen e transportit të ushqimeve për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike jane hartuar nga grupi i punës i caktuar me udhrin e Nr. 25 date 20.01.2026 sipas procesverbalit te mbajtur prej tij.

Specifikimet teknike jane hartuar duke marre ne konsiderate nevojat e Autoritetit Kontraktor, per mallrat objekt procedure prokurimi, duke perlllogaritur sasite e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombetare dhe nderkombetare, sipas parashikimeve te nenit 36, te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”, bazuar në Rekomandimin e Përbashkët të AKU dhe APP Nr. 10181 Prot datë 19.11.2018” Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të vecanta për kualifikim dhe specifikimet

teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”, dispozitat ligjore për ushqimin si dhe standartet shtetërore për karakteristikat e produkteve ushqimore të publikuara.

Në respektim të nenit 36 të LPP-së, në çdo rast nëse janë përmendur marka prodhimi, burim specifik apo proces i veçantë do të pranohen edhe ekuivalenti i tij/saj.

NJESIA E PROKURIMIT